



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
T I R A N E

Nr. 127 Akti
Datë Regjistrimi: 27/09/2017

Data e Vendimit 28/09/2017

VENDIM

“PËR SEKUESTRIMIN E TË DHËNAVE KOMPJUTERIKE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej Gjyqtarit të hetimeve paraprake, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë:

GJYQTAR: ARDIAN KALIA

Me sekretare gjyqësore Beglie NURA, mori në shqyrtim sot në dt.28/09/2017, kërkesën me palë dhe objekt si më poshtë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga Prokurori Ylli PJETËRNIKAJ.

Objekti i kërkesës: Sekuestrimin e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike, telefonit mobil të sekuestruar shtetasit F. K., në funksion të procedimit penal Nr.2814, të vitit 2017, të regjistruar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Baza Ligjore: Neni 208/a i K.Pr.Penale.

Gjykata; pasi analizoi çështjen në tërësi,

VËREN,

1. Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën me shkak ligjor dhe objekt si më lart.

2. Nga tërësia e akteve provuese të paraqitura nga ana e Prokurorisë, në mbështetje të kërkesës së mësipërme, rezulton e provuar sa vijon:

3. Në datë 24.03.2017, është paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë referimi penal nr 3608 prot datë 24.03.2017 nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Në këtë referim penal oficeri i policisë gjyqësore deklaroi se me datë 16.03.2017, është paraqitur në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë shtetasja E. G., e cila ka bërë kallëzim

penal. Në këtë kallëzim penal ajo deklaroi se shtetasi F. K., i cili është ish bashkëshorti i motrës së saj, e përndjek prej një periudhë rreth 1 vit e gjysëm, duke krijuar profile të reze në rrjetet sociale facebook dhe instagram në emrin e saj. Ky shtetas publikoi në këto profile fotografi të shtetasës E. G. dhe fotografi të tjera me natyrë seksuale, me komente denigruese dhe fyese për shtetasin E. G. dhe familjen e saj. Shtetasja E. G., ka raportuar pranë Facebook dhe Instagram profilet e reze në emrin e saj të cilat më pas janë mbyllur, por shtetasi F. K. vazhdon të krijojë profile të reze. Me anë të këtyre profileve ai komunikoi me miq dhe të afërm të saj të cilët i fyer.

4. Gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë gjyqësore, shtetasja E. G. ka shpjeguar se, shtetasi F. K. ka dërguar mesazhe kërcënuese kundrejt babait të saj. Nga ana e Prokurorisë është sekuestruar në cilësinë e provës materiale aparati celular i shtetasit F. K., me të cilin dyshohet se janë krijuar profilet e facebook dhe instagramit.

5. Bazuar në faktet e rrethanat e mësipërme dhe për nevojat të hetimeve të këtij procedimi penal, nga ana e Prokurorisë u kërkua marrja e masës së përkohshme: “Sekuestrimi i të dhënave dhe sistemeve kompjuterike, të cilat i përkasin telefonit të lëvizshëm të sekuestruar shtetasit F. K., në funksion të procedimit penal Nr.2814, të vitit 2017, të regjistruar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u kërkuar gjithashtu, të lejohet hyrja, kërkimi dhe marrja e të dhënave kompjuterike në sistemet kompjuterike objekt sekuestrimi, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimet elektronike si thirrjet hyrëse dhe dalëse, sms, çdo komunikim dhe çdo e dhënë tjetër kompjuterike e dobishme për hetimin”.

6. Gjykata pasi shqyrtoi aktet bashkangjitur të kërkesës, nga shqyrtimi tërësor i tyre si dhe në interpretim të kuadrit ligjor që disiplinon sekuestrimet në procesin penal e në veçanti, sekuestron e të dhënave kompjuterike, vlerëson se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e mbështetur ligjërisht e në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

7. LIGJI I APLIKUESHËM

Neni 208/a i Kodit të Procedurës Penale
Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike

“1. Në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, gjykata, me kërkesën e prokurorit, urdhëron sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Në këtë vendim gjykata përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik.

2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkua kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik.

3. Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose oficeri i policisë gjyqësore, i deleguar nga prokurori, merr masa: a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjesë të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash; b) për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike; c) për të penguar

hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje; ç) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.

4. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të. Eksperti i thirrur nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme....”.

Ligj nr.8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Sistem kompjuterik” do të thotë çdolloj pajisje apo grup i ndërlidhur ose pajisje të lidhura, një ose më shumë prej të cilave, vazhduese të një programi kryejnë procesime automatike të të dhënave.

b) “Të dhëna kompjuterike” do të thotë çfarëdolloj përfaqësimi të fakteve, informacioni apo konceptesh në një formë të përshtatshme për procesim në një sistem kompjuterik, që përfshijnë një program të përshtatshëm për punën e një sistemi kompjuterik për të kryer një funksion;

c) “Dhënës shërbimesh” do të thotë: (i) çfarëdo entiteti publik apo privat, që i siguron shërbimin e tij përdoruesve, me mundësinë për të komunikuar nëpërmjet një sistemi kompjuterik; dhe (ii) çfarëdo entiteti tjetër, që proceson apo memorizon të dhëna kompjuterike në të mirë të një shërbimi të këtillë komunikimi apo të përdoruesve për këtë shërbim.

d) “Të dhëna trafiku” do të thotë çdolloj të dhënash kompjuterike, të lidhura me komunikimin nëpërmjet një sistemi kompjuterik të prodhuara nga një sistem kompjuterik që përfaqëson një pjesë në zinxhirin e komunikimit, duke treguar origjinën e komunikimit(eve) destinacionin, rrugën, kohën, datën, përmasat, kohëzgjatjen apo tipin e shërbimit të poshtëshënuar....”.

Neni 14

Sfera e zbatimit të dispozitave procedurale

“...1. Çdo Palë duhet të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera të nevojshme që të vendosen kompetencat dhe procedurat e caktuara në këtë seksion për shkak të hetimeve apo gjykimeve specifike penale.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 21, çdo Palë aplikon kompetencat dhe procedurat e referuara në paragrafin 1 në:

a) veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenet 2-11 të kësaj Konvente;

b) vepra të tjera penale të kryera nëpërmjet një sistemi kompjuterik; dhe

c) mbledhje e fakteve në formë elektronike të një vepre penale.

3.a. Çdo Palë mund të rezervojë të drejtën të aplikojë masat e referuara në nenin 20 vetëm për veprat penale apo kategoritë e veprave penale, të specifikuara në rezervë, me kusht që fusha e këtyre veprave penale apo kategorive të veprave penale, nuk është më tepër e kufizuar sesa fusha e veprave penale, mbi të cilat aplikohen masat e referuara në nenin 21. Mbi çdo Palë do të konsiderojë kufizimin e një rezervimi të tillë që të mundësojë aplikim sa më të gjerë të

masave të referuara në nenin 20. b) Kur një Palë, në sajë të kufizimeve në legjislacionin të saj në fuqi në kohën e adaptimit të kësaj Konvete, nuk ka mundësi të aplikojë masat e referuara në nenet 20 dhe 21 mbi komunikimet e transmetuara brenda një sistemi kompjuterik apo një dhënës shërbimesh, sistemi i të cilit: (i) është operuar në të mirë të një grupi të mbyllur përdoruesish; dhe (ii) nuk fut në punë rrjete publike komunikimesh dhe nuk është i lidhur me një sistem tjetër kompjuterik, publik apo privat, kjo Palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë këto masa për komunikime të tilla. Çdo Palë do të konsiderojë kufizimin e rezervimeve të tilla që të mundësojë aplikim sa më të gjerë të masave të referuara në nenet 20 dhe 21....”.

8. Lidhur me Institutin e sekuestrimit, nga pikpamja doktrinale dhe jurisprudenciale, në të drejtën penale (procedurale dhe materiale), në varësi të funksionit dhe qëllimit që ndjek, në lidhje me këtë masë paraprake, rezulton se ajo parashikohet në tre forma (kuptime) kryesore:

Së pari, sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës, i parashikuar nga nenet 208 deri më 220 të KPrP.

Së dyti, sekuestrimi si një masë sigurimi, i parashikuar nga nenet 270-276 të KPrP. Ky lloj sekuestrimi përfshin sekuestron konservative (nenet 270-273 të KPrP) dhe sekuestron preventive (nenet 274-276 të KPrP).

Së treti, sekuestrimi si masë parandaluese i parashikuar nga "Ligji për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar". Ky lloj sekuestrimi ka një natyrë të veçantë dhe përbën një risi në sistemin tonë të drejtësisë penale.

9. Sekuestrimi në vetvete nënkupton marrjen ose vënien në administrim të sendeve, të objekteve apo të dokumenteve, nga ana e organit procedues, të cilat vlerësohen se shërbejnë si prova në procesin penal apo lidhen me procesin e të provuarit. Ligjshmeria e sekuestrimit si mjet për kërkimin e provës kërkon plotësimin në mënyrë komulative të disa kushteve të sanksionuara nga ligji procedural penal, të cilat ndahen në kusht të përgjithshëm dhe kushte të posaçme.

10. Ekzistenca e figurës së veprës penale, në funksion të provuëshmerisë të së cilës shërben sekuestrimi si mjet për kërkimin e provës është kushti i përgjithshëm. Legjislacioni procedural penal e lidh sekuestrimin me ekzistencën e figurës së veprës penale. Në vlerësimin e këtij kushti duhet mbajtur parasysh faza fillëstare, që paraprin procedimin penal, fazë në të cilën niveli apo standarti i provuëshmerisë nuk është tej çdo dyshimi të arsyeshëm, madje një standart të tillë nuk e kërkon ligji. Ky i fundit, kërkon që të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për ekzistencën e figurës së veprës penale. Analiza e këtij koncepti duhet të bëhet në ngjashmeri me konceptin e dyshimit të arsyeshëm të mbështetur në prova për caktimin e masës së sigurimit. Koncepti i dyshimit të arsyeshëm mbështetet në konceptin filozofik mbi të vërtetën dhe në parimin juridik të prezumimit të pafajësisë. Zbulimi i së vërtetës është një proces kompleks që realizohet gradualisht në bazë të shkallës së njohjes dhe të provave që e argumentojnë atë. Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova konsiston në krijimin e besimit në formën e probabilitetit apo mundësisë për ekzistencën e veprës penale dhe përgjegjësisë së të dyshuarit. Kjo bindje nuk është në nivelin e asaj që kërkohet për shqyrtimin gjyqësor mbi ekzistencën e elementeve të figurës së veprës penale. Një standard i tillë (dyshimi i arsyeshëm) zvogëlon mundësinë e përdorimit të këtij mjeti për kërkimin provës dhe shfaqet si

garantuese e mbrojtëse e lirisë dhe të drejtave të të dyshuarit. Kushti i ekzistencës së provave, mbi të cilat krijohet dyshimi përbën thelbin e dyshimit të arsyeshëm. Janë të mjaftueshme dyshimet e bazuara në nivelin e arsyes, të pranueshme nga njeriu me një logjikë normale që gjykon paanshmërisht. Nuk kërkohet bindje. Kjo do të thotë që veprimtaria provuese vazhdon.

11. Në këtë kontekst, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së nuk kërkohet një nivel i lartë i të provuarit sipas standardit të dyshimit të arsyeshëm. Mjafton, sipas GJEDNJ, që dyshimi i arsyeshëm duhet të jetë i sinqertë dhe në mirëbesim. Standardi i të provuarit "Dyshimi i arsyeshëm", i referuar në Nenin 5/1(c) të KEDNJ-së, që një veprë penale është kryer, presupozon ekzistencën e fakteve ose informacioneve që do të bindin një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer një veprë penale. Pra, i kushtohet rëndësi mundësisë se është kryer veprë penale dhe jo sigurisë se plotë se është kryer. GJEDNJ ka vënë në dukje kriteret të cilat përcaktojnë kuptimin e standardit të dyshimi të arsyeshëm:

Të ekzistojnë fakte ose informacione që ekziston figura e veprës penale.

Këto fakte dhe informacione të krijojnë bindjen tek një vëzhgues objektiv,

Dyshimi të jetë i arsyeshëm.

12. Në rastin konkret të tre kriteret e përmendura me sipër lidhur me dyshimin e arsyeshëm ekzistojnë. Raportin e shërbimit, procesverbali i kqyrjes i të dhënave në internet, dëshmitari E. G., procesverbali i sekuestrimit të provave materiale paraqesin fakte duke krijuar kështu edhe dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova.

13. Për sa më lart u argumentua, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret provohet plotësisht ekzistenca e kushteve me të cilat ligji procedural penal e më konkretisht, neni 208/a i K.Pr.Penale, lidh mundësinë e sekuestrimit të të dhënave e sistemeve kompjuterike si dhe aksesin për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhëna kompjuterike që lidhen me veprën penale objekt hetimi, të cilat gjenden në aparatet celular të sekuestruar në cilesinë e proves materiale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 112, 208/a të K.Pr.Penale

VENDOSI

Pranimin e kërkesës.

Sekuestrimin e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike, të cilat i përkasin telefonit të lëvizshëm të sekuestruar shtetasit F. K., në funksion të procedimit penal Nr.2814, të vitit 2017, të regjistruar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Të lejohet hyrja, kërkimi dhe marrja e të dhënave kompjuterike në sistemet kompjuterike objekt sekuestrimi, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimet elektronike si thirrjet hyrëse dhe dalëse, sms, çdo komunikim dhe çdo e dhënë tjetër kompjuterike e dobishme për hetimin. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori të mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të, duke respektuar regjimin juridik që parashikon neni 208/a i K.Pr.Penale.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë sipas përcaktimeve të ligjit procedural penal.
U shpall në Tiranë, sot më dt.28/09/2017.

SEKRETARE
BEGLIE NURA

**

GJYQTAR
ARDIAN KALIA